

LEONARD DAUTI

MBI ALOMORFINË E PRAPASHTESAVE FJALËFORMUESE NË GJUHËN SHQIPE

Përmbledhja

Ndajshtesimi, si rruga më prodhimore e pasurimit të leksikut në gjuhën shqipe, mbetet edhe një ndër mënyrat më të studiuara të fjalëformimit në gjuhësinë shqiptare. Jo vetëm për larminë e mjeteve përkatëse morfologjike, parashtesave dhe prapashtesave, por para së gjithash për kompleksitetin e dukurive që lidhen me të. Në këtë punim do të shqyrtojmë prapashtesat alomorfe, përkatësisht ato prapashtesa të pranuar që ekzistojnë në çifte alomorfesh, si *-tar/-ëtar*, *-si/-ësi*, *-ri/-ëri*, *-llo/-ëllo* etj., falë daljes së një *-ë*-je epentetike në kufirin temë-prapashtesë. Interpretimi i derisotëm se në këto raste kemi daljen e një */ë*-je mbështetëse midis temës fjalëformuese dhe prapashtesës, e cila bëhet pjesë e prapashtesës, do të jetë objekt i një shqyrtimi kritik. Synimi i analizës së zhvilluar këtu është të provohet, brenda kornizës së morfologjisë së konstruksioneve, se në këto raste kemi një prapashtesë të përfaqësuar nga një morf i vetëm dhe jo dy alomorfe të së njëjtës prapashtesë. Elementi fonetik */ë* është një kërkesë e strukturës prozodike të fjalës së re komplekse dhe nuk ka të bëjë me strukturën morfologjike të saj.

Fjalë kyç *alomorf, morf, prapashtesë, fjalëformim, ndajshtesim, konstruksion, proces, morfologji*

Parashtrim

Ndër dy llojet e ndajshtesimit të pranishme në fjalëformimin e gjuhës shqipe, prapashtesimi vlerësohet të ketë përparësi në prodhimtari përkundër parashtesimit. E gjejmë me vend të theksojmë se është më i saktë vlerësimi që ky tip është më prodhimtari jo vetëm brenda ndajshtesimit, por edhe në krahasim me mënyrat e tjera fjalëformuese, si kompozimi, konversioni e përngjitja, të pranishme në gjuhën shqipe për formimin e emrave, mbiemrave, foljeve e ndajfoljeve (Hysa, 2004:107). Vetëm numri i prapashtesave është përcaktuar gati tri herë më i madh se ai i parashtesave (Dhrimo et al., 1976:38; Agalliu et al., 2002:64, Hysa, 2014). Një dukuri e pranishme në bashkësinë e

parashtesave dhe të prapashtesave është edhe ajo e alomorfisë. Kështu, parashtesa që shërben për krijimin e foljeve me kuptimin e kundërt të foljes bazë, përkatësisht zhbërjen e asaj që shënon folja bazë, del me tri alomorfet përkatëse: /sh-/zh-/ç-/, në varësi të bashkëtingëllores nistore të temës bazë. Kur tema bazë fillon me një bashkëtingëllore jo të zëshme kemi alomorfin /sh-/, kur tema fillon me një bashkëtingëllore të zëshme kemi alomorfin /zh-/, ndërsa kur tema fjalëformuese fillon me një bashkëtingëllore hundore kemi alomorfin /ç-/.

(1) sh-	formoj	shformoj
zh-	vendos	zhvendos
ç-	montoj	çmontoj

Alomorfet janë pranuar edhe për një numër të madh prapashtesash. Ndër to një grup të madh përbëjnë ato prapashtesa, alomorfet e të cilave janë përcaktuar mbi bazën e pranisë ose mospranisë së një -ë-je të paravendosur. Kjo /ë/ [ə] shfaqet në ato raste, por jo domosdoshmërisht gjithmonë, kur prapashtesa që fillon më bashkëtingëllore i bashkohet një teme fjalëformuese, ndryshe temë bazë, që mbaron më bashkëtingëllore. Ndër këto prapashtesa mund të përmendim: -ko/-ëko, -lo/-ëlo, -lle/-ëlle, -lli/-ëlli, -llo/-ëllo, -ri/-ëri, -rit/-ërit, -rlo/-ërlo, -rmo/-ërmo, -ro/-ëro, -rro/-ërro, -s/-ës, -si/-ësi, -sirë/-ësirë, -so/-ëso, -tar/-ëtar, -ti/-ëti, -to/-ëto, -zo/-ëzo (shih: Xhuvani & Çabej, 1956, 1964¹; Dhrimo et al., 1976; Agalliu et al., 2002; Hysa, 2004; Buxheli, 2008; Hysa, 2014, Genesin & Matzinger, 2016). Brenda këtij grupimi jo të vogël prapashtesash dalja e /ë/-së kushtëzohet nga faktorë të ndryshëm, e për pasojë paraqet edhe tipologji të ndryshme. Prapashtesa -s, p.sh., e ka të kushtëzuar fonologjikisht daljen e saj; ajo del pas një teme që mbaron më zanore, ndërsa në të gjitha rastet kur tema fjalëformuese del më bashkëtingëllore, para saj del një /ë/. Sipas interpretimit të deritanishëm në studimet tona, fjalëformimi i emrave të vepruesit nga temat foljore me anën e kësaj prapashtese mund të paraqitet në këtë mënyrë:

(2)	<i>nxënë</i> -s → <i>nxënë</i> s
	<i>vjelë</i> -s → <i>vjelë</i> s
	<i>mësue</i> -s → <i>mësue</i> s
	<i>shikue</i> -s ² → <i>shikue</i> s

¹ Xhuvani dhe Çabej pranojnë vetëm prapashtesën -tar dhe nuk bëjnë fjalë për një variant -ëtar (Xhuvani & Çabej, 1980:545). Edhe Genesin & Matzinger (2016:3127) sjellin shembuj vetëm me këtë prapashtesë, pa përmendur variantin -ëtar. Nuk jemi të sigurt për të gjykuar nëse në këtë rast kemi të bëjmë me një qëndrim teorik të autorëve, apo me mospasqyrim të shembujve me praninë e -ë-së mbështetëse.

² Ndryshe nga mendimi i Çabejt & Xhuvanit dhe ai i gramatikës së Akademisë që pranojnë prapashtesën -ues, në këtë punim do t'i qëndrohet mendimit se në këtë rast

hap -ës → *hapës*
mbyt -ës → *mbytës*
zhyt -ës → *zhytës*

Prapashtesa të tjera që respektojnë të njëjtën ligjësi, sikurse *-s/-ës*, në përndarjen e tyre janë: *-llo/-ëllo*, *-ro/-ëro*, *-zo/-ëzo*, *-llit/-ëllit*, *-rit/-ërit*.

Për të gjitha prapashtesat e tjera, të cilat formojnë një grup relativisht të madh, dalja e /ë/-së para tyre nuk ndodh detyrimisht pas një teme më bashkëtingëllore. E përbashkëta mes tyre ka të bëjë me faktin që ato dalin në një rrethim fonologjik të ngjashëm dhe shfaqja apo mosshfaqja e *-ë/-së* nuk diktohet nga bashkëtingëlloret përkatëse që e rrethojnë, para dhe pas saj, por nga shkaqe të tjera, kryesisht të strukturës prozodike të fjalës komplekse. Numri i këtyre çifteve alomorfike është i madh, por për arsye studimi do të ndalemi vetëm në një grupim të vogël prapashtesash, përkatësisht në çiftet *-tar/-ëtar*, *-ri/-ëri*, *-si/-ësi*, të cilat paraqesin veçori të përbashkëta tipologjike. Prapashtesa *-tar/-ëtar* shërben për të formuar emra vepruesi sipas profesionit/mjeshtërisë, ose edhe mbiemra, kryesisht nga tema emërore dhe shumë pak tema foljore (Hysa, 2004:162-163), ndërsa ato *-ri/-ëri* dhe *-si/-ësi* formojnë emra abstraktë nga tema mbiemërore ose edhe emërore (Po aty, 141, 143), siç jepen edhe në shembujt e mëposhtëm.

(3) $[[X]_{EMb-Y}]_{EMb}$ ku: *Y = prapashtesa përkatëse*

varg_E-(ë)tar → *vargëtar_E*

treg_E-(ë)tar → *tregtar_E*

komb_E-(ë)tar → *kombëtar_M*

fatkeq_{Mb}-(ë)si → *fatkeqësi_E*

bimë_E-(ë)si → *bimësi_E*

i tretshëm_{Mb}-(ë)ri → *tretshmëri_E*

djalë_E-(ë)ri → *djalëri_E*

kemi vetëm prapashtesën *-s*. Modeli i fjalëformimit të emrave të vepruesit, përkatësisht i mbiemrave, mbi bazën e pjesores që dilte më *-ue*: *shkrue*, *lexue*, *punue* etj., i përket gegërishtes, prej së cilës u huazua edhe në toskërishten letrare e për pasojë edhe në shqipen standarde. Ky model fjalëformimi vepron sot automatikisht edhe në kushtet e mospërfshirjes së pjesores e paskajores përkatëse në variantin standard. Pranimi i një prapashtese *-ues* për variantin standard bie ndesh me realitetin gjuhësor të gegërishtes, ku *-ues* kurrësi nuk ndihet si prapashtesë, pasi ekziston kundërvënia *pjesore – emër vepruesi*: *punue – punues*, *lexue – lexues*, *dëgjue – dëgjues*, *shikue – shikues* etj. Nga ana tjetër, pranimi i një prapashtese që i përket vetëm shqipes standarde, duke u mbështetur në ndjesinë gjuhësore të folësve (toskë) të variantit standard, do të duhej të vërtetohej edhe nga prodhimitaria e saj. Deri tani nuk kemi raste që të vërtetojnë se një prapashtesë e tillë është shtrirë përtej rasteve të foljeve që në gegërishte dalin me pjesore më *-ue*. Kjo do të thotë që ky model fjalëformimi është i njëjtë si në gegërishte edhe në shqipen standarde.

Për shënimin e prapashtesave në (3) kemi ndjekur traditën e gramatikave tona: *-(ë)tar*, *-(ë)si*, *-(ë)ri*. Kjo mënyrë paraqitjeje është ambigue, pasi lejon dy interpretime: (i) kemi një prapashtesë që fillon më bashkëtingëllore, por që në rastet e bashkimit me tema bazë që mbarojnë më bashkëtingëllore asaj i shtohet një /ë/ në pozicion nistor: *-(ëtar)*; (ii) kemi një prapashtesë që fillon më bashkëtingëllore, para së cilës shfaqet një /ë/ që nuk mund të interpretohet si pjesë e saj: *-(ë-tar)*. Vetëkuptohet që interpretimi i parë i referohet prapashtesës si njësi hyrëse në procesin morfologjik fjalëformues, ndërsa interpretimi i dytë i referohet prapashtesës si pjesë e strukturës së fjalës komplekse të përftuar nga procesi morfologjik fjalëformues. Mënyra e mësipërme e paraqitjes së prapashtesës s'është në përputhje me interpretimin sipas të cilit në procesin ngjizës fjalëformues si njësi hyrëse marrin pjesë alomorfe të përkatese të saj. Dykuptimësia që buron nga mënyra e shkrimit të prapashtesave përkatese i përgjigjet në mënyrën më besnike paqartësisë që buron nga interpretimi i mjegullt i ekzistencës së varianteve apo alomorfeve për të njëjtën prapashtesë në punimet e deritanishme mbi fjalëformimin.

Në analizën morfologjike fjalëformuese procesi i krijimit të fjalëve të reja analizohet duke u nisur nga fjala komplekse, rezultati i përftuar prej tij, ose njësia dalëse, dhe mbi bazën e marrëdhënieve paradigmatiche sistematike midis fjalëve të derivuara dhe temave bazë, si njësi hyrëse në proces për krijimin e tyre, arrihet të hidhet dritë edhe mbi njësitë e tjera hyrëse, përkatesisht mbi prapashtesat që marrin pjesë në të. Nëse temat bazë e dëshmojnë pavarësinë e tyre si pjesë e leksikut tonë, prapashtesat ekzistojnë si pjesë përbërëse e konstrukcionit përkates të fjalëve komplekse. Për këtë arsye është tepër e vështirë të flitet me të njëjtën siguri për formën e tyre si njësi hyrëse, sikurse për atë të temës bazë, duke u nisur nga forma përfundimtare e fjalës së përftuar. Për arritjen në përfundime sa më të sakta në lidhje me prapashtesën si njësi hyrëse, në kushtet kur për gjykimin e saj nisemi nga fjala komplekse, merr përparësi qasja teorike që ndiqet për analizën përkatese. Analiza e fjalëformimit e zbatuar në gramatikat tona, kryesisht mbi bazën e qasjes strukturaliste, duke u mbështetur mbi morfemën si njësi bazë morfologjike³, e ka pasur të detyrueshme ta përfshijë elementin /ë/ si pjesë të njëres prej dy njësive hyrëse në fjalëformim, të temës bazë ose të prapashtesës. Por, nga ana tjetër, ajo e ka pasur të pamundur për të shpjeguar motivimin e përfshirjes së saj pikërisht si pjesë të prapashtesës.

³ Në *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe* Buxheli i është larguar teorikisht qasjes tradicionale, përmes konceptimit të fjalëformimit si një proces që nuk bazohet mbi morfemën si njësi bazë. Sipas saj, si temë fjalëformuese mund të dalë një morfemë, një temë morfologjike, por edhe një fjalëformë e caktuar, si *punonj* në *punonjës*.

Një fjalë, e detyrimisht edhe një fjalë e derivuar, shfaqet si një strukturë e trefishtë, pra si bashkekzistencë e tri strukturave paralele: strukturës fonologjike, strukturës morfologjike dhe strukturës semantike (Booij, 2007:154). Komponenti formë është një ndërveprim i strukturës morfologjike me atë fonologjike. Përfaqsa midis strukturës fonologjike të njësive hyrëse në procesin morfologjik fjalëformues dhe strukturës fonologjike të njësisë dalëse nga ky proces mund të shërbejë si rruga më e saktë e analizës për të përcaktuar ndryshimet përkatëse. Nga ana tjetër, kjo do të mundësojë për të kuptuar nëse bashkimi i dy njësive morfologjike për krijimin e një strukture të re krijon apo jo kushtet e përshtatshme fonologjike për shfaqjen e alomorfsisë. Parimi që do të ndiqet në këtë analizë kërkon që të respektohet dallimi i qartë midis strukturës morfologjike dhe strukturës fonologjike, si dhe bashkëveprimi i ndërsjellë mes tyre. Në analizën e mëposhtme do të synohet të vërtetohet hipoteza se njësia e re komplekse morfologjike në shumicën e rasteve përfaqësohet nga një strukturë e re fonologjike, e cila nuk respekton detyrimisht organizimin fonologjik të njësive hyrëse në proces. Kjo do të thotë që elementet e bashkuara në një strukturë të re morfologjike u nënshtrohen edhe ligjësive të riorganizimit fonologjik të fjalës së re komplekse.

Objekt i analizës në këtë punim do të jenë prapashtesat *-tar/-ëtar*, *-si/-ësi*, *-ri/ëri* si përfaqësuese të grupit të prapashtesave para së cilave dalja e /ë/-së, kur ato bashkohen me tema më bashkëtingëllore, nuk është dukuri e rregullt. Synimi i analizës është të përcaktohen kushtet fonologjike apo morfologjike të shfaqjes së /ë/-së, si dhe vendi i saj në strukturën e fjalës së prejardhur, për të arritur në përfundime sa më të sakta në lidhje me alomorfinë e prapashtesave përkatëse. Rasti i prapashtesës *-s/-ës* do të trajtohet i veçuar, për shkak të veçorive tipologjike që paraqet kjo prapashtesë. Për të argumentuar hipotezën e këtij punimi do të shërbejnë si objekt analize shembuj të krijimit të fjalëve komplekse në të cilët dëshmohet mospërputhje midis strukturës fonologjike të njësive hyrëse dhe asaj të njësisë dalëse nga procesi fjalëformues. Rastet kur struktura hyrëse dhe ajo dalëse përputhen, sidomos për sa i përket inventarit të fonemave pjesëmarrëse, nuk krijojnë mundësi për të bërë një dallim të qartë midis strukturës morfologjike dhe asaj fonologjike, por përfaqsa midis dy rasteve do të mëtojë të hedhë dritë edhe mbi dukuri të pavërejtura më parë.

Vështrim kritik mbi alomorfinë e prapashtesave

Prania ose mosprania e -ë-së si fonemë nistore e prapashtesës, në studimet e deritanishme, është parë si e kushtëzuar nga natyra e temës bazë me të cilën ajo bashkohet: kur tema bazë përfundon më bashkëtingëllore, kemi praninë e -ë-së, ndërsa kur tema mbaron më zanore, -ë-ja nuk është e pranishme (Çeliku et al., 1998:318; Hysa, 2004:141; Buxheli, 2008:183). Siç mund të shihet edhe nga shembujt në (3) në strukturën e fjalëve të prejardhura të krahut të djathtë mund të vërehet prania e dy njësive segmentore, të cilat fillimisht po i quajmë

variante të së njëjtës prapashtesë, që kundërvihen me njëra-tjetrën vetëm në praninë/mospraninë e fonemës /ë/. Morfologjikisht këto fjalë komplekse mund t'i analizojmë në këtë mënyrë: *varg* ⊕ *ëtar*, *treg* ⊕ *tar*, *fatkeq* ⊕ *ësi*, *bimë* ⊕ *si*, *tretshm* ⊕ *ëri*, *djalë* ⊕ *ri*. E njëjta prapashtesë del e përfaqësuar me dy morfet përkatëse: *ëtar* : *tar*; *ësi* : *si*; *ëri* : *ri*. Pra, brenda strukturës së fjalëve komplekse të ndryshme e njëjta prapashtesë shfaqet me dy alomorfet e saj.

Në analizën e prapashtesave *-llo/-ëllo* që formojnë folje Buxheli thekson se “Zanorja /ë/ e alomorfit *-ëllo*, është shtesë fonetike ndërmjet temës dhe prapashtesës, që zakonisht bëhet për lehtësi shqiptimi, kur tema fjalëformuese mbaron me bashkëtingëllore: *zbardhëlloj* (zbardh-ëllo).” (Buxheli, 2008:183). Një interpretim i tillë, ndonëse nuk bazohet në ndarjen njësi hyrëse - njësi dalëse të procesit fjalëformues, lë të kuptohet që si element hyrës në procesin fjalëformues merr pjesë një prapashtesë e unifikuar pa elementin /ë/, pra *-llo*. Zanorja /ë/ interpretohet si shtesë fonetike ndërmjet temës dhe prapashtesës, çka lë të nënkuptohet se procesi morfologjik fjalëformues nuk është konceptuar prej autores si një proces i thjeshtë i bashkimit mekanik të temës me prapashtesën. Por, nga ana tjetër, mbetet e paqartë, më saktë e paargumentuar, se përse, p.sh., /ë/-ja duhet marrë si pjesë e prapashtesës, alomorfit *-ëllo*, dhe jo, p.sh., e temës. Duket që, duke shmangur çdo lloj keqkuptimi, interpretimi i ofruar në këtë rast nuk shkon përtej kornizës së konceptimit të kësaj dukurie prej traditës sonë gramatikore:

“Në kushte të caktuara fonetike midis temave më bashkëtingëllore dhe prapashtesave që nisin gjithashtu më bashkëtingëllore, hyn një *-ë-* mbështetëse, p.sh.: *mal-ë-si*, *lajm-ë-tar*. Në analizën morfemore kjo *-ë-* merret si tingull i prapashtesës, kështu që një numër prapashtesash dalin me dy trajta të kushtëzuara fonetike: *-tar/-ëtar*, *-si/-ësi*, *-ri/-ëri* etj. (khs. *vogël-si*, *arsim-tar* etj. ku *-ë-*ja mbështetëse nuk shfaqet).” (Dhrimo et al., 1976:38; Agalliu et al., 2002:64)

Formulimi i mësipërm përmban tri pohime të rëndësishme: (i) prania e dukurisë fonetike të shfaqjes së *-ë-*së mbështetëse midis bashkëtingëllores së temës dhe asaj të prapashtesës; (ii) marrëveshja (për pasojë: vendim arbitrar) për ta përfshirë këtë zanore mbështetëse si pjesë të prapashtesës, çka ka çuar drejt pranimit të alomorfeve përkatëse; (iii) dy shembuj (*vogëlsi*, *arsimtar*) në të cilët *-ë-*ja mbështetëse nuk shfaqet, ndonëse pohimi (i) e presupozon daljen e saj. Këta dy shembuj janë një kundërgargument i gatshëm ndaj pohimit (i), çka nxjerr në pah kontradiktën që karakterizon pohimin e mësipërm.

Vendimi për ta përfshirë *-ë-*në si pjesë të prapashtesës është për t'u vlerësuar si arbitrar, pasi ekzistojnë edhe mundësi të tjera për interpretimin e saj, të cilat jo vetëm nuk janë marrë parasysh, por as nuk është bërë një argumentim sado i paktë që të mund të hidhte dritë mbi arsyet e përzgjedhjes në fjalë. Një mundësi interpretimi është ajo e përkufizimit të saj si mjet që

shërben për modifikim të temës, për përshtatje të saj në procesin ngjizës të bashkimit me një prapashtesë që fillon më bashkëtingëllore. Në këtë rast do të kishim këtë interpretim të strukturës së fjalës komplekse: *varg(ē↑)-tar*. Dhe nuk do të flitej për dy alomorfe të së njëjtës prapashtesë, por për një mjet morfologjik (-ē-) të pranishëm në strukturën e temës bazë. Një tjetër interpretim i mundshëm do të ishte ai i një ndërmorfemori që del në pozicionin midis dy njësive fjalëformuese sa herë e kërkon ruajtja e strukturës morfologjike të fjalës komplekse. Në këtë rast analiza morfologjike fjalëformuese do të ishte: *varg-(ē↑)-tar*, ku -ē-së i caktohet një vend midis dy njësive, temës bazë *varg* dhe prapashtesës-*tar*. Marrja parasysh e kësaj mundësie do të kërkonte që të pranohej prania e njësive segmentore elementare që nuk mbulohen nga koncepti i morfemës, përkatësisht e ndërmorfemorëve. Duke qenë se baza teorike ku janë mbështetur dy gramatikat e cituara nuk e përfshin konceptimin e njësive të tilla, vetëkuptohet që një mundësi e tillë interpretimi është përjashtuar apriori.

Është ndofta e pavend të gjykohet apo të mbahet qëndrim kritik ndaj mosmarrjes parasysh të mundësive të tjera interpretuese të elementit /ë/ brenda strukturës së fjalës komplekse. Mbështetja e analizës së strukturës së fjalës mbi morfemën, nga njëra anë, dhe e asaj fjalëformuese mbi temën fjalëformuese dhe ndajshitesën-morfemë, nga ana tjetër, i kanë detyruar autorët e gramatikave të sipërcituara të bëjnë një zgjidhje arbitrare praktike paralele me atë që kanë ofruar edhe për sistemin flektiv: -ē-ja mbështetëse i bashkohet prapashtesës, sikurse -v-, p.sh., i bashkohet mbaresës së aoristit: *puno-va*, *puno-ve*. Në këtë mënyrë dilet me një qëndrim të unifikuar dhe shmanget kompromentimi i analizës morfologjike të mbështetur mbi morfemën si njësi bazë dhe e vetme e saj.

Nisur nga struktura e fjalës komplekse, mund të përcaktohet jo vetëm struktura fonologjike e prapashtesave përkatëse, por edhe ndryshimet që mund të pësojë tema bazë, si në rastin e *tretshmëri*, në të cilën -ē-ja e rrokjes fundore të temës bazë nuk mund të qëndrojë për shkak të strukturës prozodike të fjalës komplekse: (i) *tretshëm ⊕ -ëri* → **tretshë\m ⊕ ëri* → *tretshmëri*. Gjithashtu është më i lehtë përcaktimi i temës bazë si njësi hyrëse e procesit fjalëformues, pasi ajo përgjithësisht përputhet me temën e një lekseme që ekziston në leksikon tonë mendor, por jo e strukturës fonologjike të prapashtesës përkatëse, duke qenë se kjo ekziston vetëm brenda strukturës së fjalëve komplekse dhe jo si pjesë e mëvetësishme e leksikut tonë mendor.

Çështja shtrohet: *Si njësi hyrëse në procesin fjalëformues kemi alomorfin përkatës të prapashtesës, i cili zgjidhet në varësi të natyrës së temës bazë, apo kemi vetëm një prapashtesë të unifikuar, e cila bëhet shkak i ndryshimeve fonemore përkatëse në procesin ngjizës të bashkimit të saj me temën bazë?* Për të arritur te mbajtja e një qëndrimi sa më të argumentuar do të duhet ta mbështesim analizën tonë në dallimin midis njësive hyrëse dhe atyre dalëse të

procesit fjalëformues. Ky dallim nuk është analizuar në mënyrë eksplicite në trajtimet e deritanishme të fjalëformimit dhe kjo ka bërë që mjaft formulime apo përgjithësime në lidhje me temën bazë dhe vetë ndajshesat të jenë të mjegullta, të dykuptimshme, apo edhe kontradiktore.

Rivlerësim i kushtit fonologjik për daljen e zanores së patheksuar /ë/

Dalja e zanores /ë/ është një dukuri e mirëpranuar edhe nga autorë të tjerë që janë marrë me fjalëformimin (Xhuvani & Çabej, 1980 [1964]; Çeliku et al., 1998; Hysa, 2004; Buxheli, 2008). I diskutueshëm është vetëm përcaktimi i saktë i kushtit fonetik për daljen e saj, si dhe përcaktimi i saktë i vendit të saj në strukturën morfologjike të fjalës komplekse. Nëse pohimi se kjo /ë/ del pas një teme që mbaron dhe para një prapashtese që fillon më bashkëtingëllore është i vërtetë, atëherë nuk duhet të ekzistojnë raste të mospranisë së saj, kur ky kusht fonetik përmbushet. Por rastet që bien ndesh me këtë pohim janë aq të shumta sa nuk mund të trajtohen si shmangie nga rregulli: *arsimtar, çlirimtar, shkaktar, tregtar, themeltar, leshtor, afërsi, ëmbëlsi, vjetërsi, vogëlsi, zgjuarsitj*.⁴ Prania e këtyre rasteve kërkon që pohimi i mësipërm të specifikohet më tej. Mund të pohohet me njëfarë sigurie që -ë-ja mbështetëse del gjithmonë në rastet kur tema bazë mbaron më dy bashkëtingëllore (shih edhe Boriçi, 1991:165-166): *lajmëtar, bujqësi, harkëtar, kombësi, kombëtar, krejtësisht, mundësi, vargëtar* etj., por nga ana tjetër kemi *zdrukthëtar*, në të cilën -ë-ja është vetëm dukuri shkrimore dhe joshqiptimore. As natyra e bashkëtingëllores fundore nuk mund të shërbejë si kriter diferencues, pasi nuk mund të gjendet një rregullsi mbi bazën e së cilës mund të përcaktohet dalja e -ë-së mbështetëse. Ajo del pas bashkëtingëlloreve të zëshme (*rrugëtar*), jo të zëshme (*drejtësi, kënaqësi*,) dhe hundore (*zjarrmëtar*), sikurse edhe mund të mungojë pas tyre (*kryqtar, mërgimtar*). Nga analiza e rasteve që nuk dëshmojnë praninë e -ë-së mbështetëse kemi gjykuar si më të pranueshëm për shpjegimin e kësaj dukurie mendimin se mosdalja e saj shoqërohet me një zanore të shkurtër në rrokjen fundore të temës bazë. Kushtëzimi fonetik do të mund të formulohej në këtë mënyrë: **dalja apo mosdalja e -ë-së mbështetëse në strukturën e fjalës**

⁴ Për një listë më të plotë të fjalëve të tilla shih *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe* § 5.c. Numri i këtyre fjalëve është edhe më i madh, po të kihet parasysh që edhe shqiptimi i një sërë fjalësh, për të cilat *Drejtshkrimi ...* rekomandon shkrimin me -ë- mbështetëse, nuk dëshmon praninë e një foneme të tillë: *mjekësi* [mjeksi], *malësi* [malsi], *malësor* [malsor], *shëndetësi* [shëndetsi] etj. Dallimi midis shkrimit dhe shqiptimit në analizën e kombinimit të bashkëtingëllore në kufirin temë-prapashtesë shpesh është injoruar. Kështu, në analizën statistikore të kësaj dukurie, duke u mbështetur vetëm në variantin e shkruar, i cili, për hir të së vërtetës, nuk pasqyron saktësisht shqiptimin, është konstatuar prania e kombinimit /ksh/: *thekshëm*, por jo ajo e kombinimit /ks/ (Karagjozi, 2009:88).

komplekse, të formuar nga një temë bazë më bashkëtingëllore dhe një prapashtesë që fillon më bashkëtingëllore, është e kushtëzuar nga gjatësia e zanores së rrokjes fundore të temës bazë.⁵

Veprimi i një ligjësie të tillë duket më qartë në raste si *flamurtar, oborrtar, themeltar, zelltar* etj., tema bazë e të cilave, kur përdoret si njësi leksikore e mëvetësishme, karakterizohet nga një zanore e gjatë ose normale: *flamur, oborr, themel, zëll*. Si pjesë e fjalës komplekse, këto tema e ndryshojnë gjatësinë e zanores së rrokjes fundore që në mjaft raste mund të përputhet me zanoren e theksuar të temës: dalin me zanore të shkurtër. Edhe në rastet për të cilat drejtshkrimi rekomandon shkrimin me *-ë-* mbështetëse, si *mjekësi, shëndetësi, malësi, malësor*, kemi të pranishme një zanore të shkurtër në temën bazë, prandaj në shqiptimin e tyre vështirë se vërehet ndonjë gjurmë e *-ë-së*. Për shkrimin e këtyre rasteve nuk është zbatuar as parimi fonetik dhe as ai morfologjik. Në rastet kur zanorja e rrokjes fundore të temës fjalëformuese ruan gjatësinë normale, ose del si zanore e gjatë, atëherë kemi shfaqjen e *-ë-së* midis temës dhe prapashtesës përkatëse: *kombëtar, zjarrmëtar, ligësi, shterpësi* etj. Kjo na çon drejt këtij rregulli specifik të ndërvarësisë mes daljes/mosdaljes së *-ë-së* mbështetëse dhe gjatësisë së zanores: Në të gjitha rastet kur në strukturën e fjalës komplekse rrokja fundore e temës fjalëformuese del me një zanore të shkurtër, në pozicionin midis kësaj teme dhe prapashtesës nuk shfaqet *-ë-ja* epentetike.⁶

⁵ Ideja e lidhjes së dukurisë së shfaqjes a mosshfaqjes së zanores mbështetëse me gjatësinë a shkurtësinë e zanores në rrokjen fundore të temës fjalëformuese, në fjalë të formuara nga tema me bashkëtingëllore dhe me prapashtesa që nisin po me bashkëtingëllore, i përket studiuesit dhe kolegut Albert Riska. Këtë mendim e ka shprehur në një bisedë mbi këtë çështje, më 15 maj 2021.

⁶ Pohimi i një rregulle të tillë kërkon detyrimisht mbështetjen nga analiza akustike e fonemave përkatëse. Në kushtet e mungesës së një laboratorit fonetik për zhvillimin e një analize të saktë akustike, analizuam me programin kompjuterik “Praat”, versioni 6.1.48, në sistemin “Macintosh”, versioni 10.13.6, një krahasim midis gjatësisë së zanores së temës fjalëformuese, ose asaj të rrokjes së fundit të saj, në fjalën komplekse me atë të po së njëjtës zanore në fjalën që ka shërbyer si temë fjalëformuese. Krahasuam këto çifte fjalësh: *flamur - flamurtar, mjek - mjekësi* [mjeks’i], *treg - tregtar, zell - zelltar, ëndërr - ëndërrtar, bajrak - bajraktar, furrë - furrtar, gjah - gjahtar, gjyq - gjyqtar, këshill - këshilltar, kishë - kishitar, kryq - kryqtar, kujdes - kujdestar, lojë - lojtar, lundër - lundërtar, meshë - meshtar, nevojë - nevojtar, oborr - oborrtar, pishë - pishtar, pyll - pylltar, rojë - rojtar, shkak - shkaktar, shteg - shtegtar, tym - tymtar, valle - valltar, zdrukth - zdrukthëtar* [zdruk0t’ar], *zeje - zejtar*. Nga analiza u vërejt se në përbërje të fjalës komplekse zanorja përkatëse, në rrokjen para prapashtesës, del me një gjatësi të reduktuar në të gjitha rastet, çka mbështet edhe pohimin tonë mbi varësinë midis mosdaljes së *-ë-së* mbështetëse dhe gjatësisë së zanores që del në rrokjen fundore të temës fjalëformuese. Gjithsesi, një analizë e saktë

Rastet e mosshfaqjes së *-ë-së* mbështetëse, në fjalë komplekse si *arsimtar*, *tregtar*, *shtegtar*, *leshtor*, *afërsi*, *vogëlsi* etj., dëshmojnë se si njësi hyrëse në procesin morfologjik fjalëformues merr pjesë një prapashtesë e unifikuar dhe jo njëri prej alomorfeve të saj. Rastet e marra në shqyrtim më sipër për prapashtesën *-tar* dëshmuar se dalja e *-ë-së* nuk është e kushtëzuar nga natyra e bashkëtingëllores fundore të temës bazë, çka do të thotë se tema bazë nuk kërkon një alomorf të caktuar për t'u bashkuar. Gjithashtu, ndryshimi i gjatësisë midis së njëjtës zanore, në temën bazë dhe në fjalën komplekse, është një argument në të mirë të idesë se *-ë-në* mbështetëse e kërkon struktura prozodike e fjalës komplekse dhe jo tema bazë apo prapashtesa si pjesë përbërëse të strukturës morfologjike. Ky është një nga rastet kur struktura morfologjike⁷ dhe ajo fonologjike e fjalës nuk përputhen plotësisht me njëra-tjetrën. Organizimi prozodik (fonologjik) i fjalës kërkon një element [ə] që ndërfitet në procesin ngjizës fjalëformues, por që nuk i përket asnjërës prej dy njësive morfologjike hyrëse që marrin pjesë në të.

Për ta sqaruar më hollësisht këtë ide po analizojmë fjalën *harkëtar*. Struktura fonologjike e *harkëtar* është ajo e një fjale fonologjike (ω) të përbërë nga tri rrokje (σ), (*har*) $_{\sigma}$, (*kë*) $_{\sigma}$ dhe (*tar*) $_{\sigma}$, dhe tetë segmente fonologjike.




Figura 1: Struktura e trefishtë e fjalës komplekse *harkëtar*

Përjasja e tri strukturave nxjerr në pah se midis strukturës fonologjike dhe asaj morfologjike nuk kemi përputhje simetrike. Tema hyrëse në proces, ose

akustike, e cila do të ishte e pakundërshtueshme për sa i përket saktësisë shkencore, mbetet çështje e së ardhmes.

⁷ Struktura morfologjike nuk konceptohet si organizim linear i morfemave që mund të identifikohen në përbërje të fjalës (konstruktiv morfologjik sintetik), por si organizim hierarkik, në nivelin më të lartë të së cilit mund të dallohet tema morfologjike dhe morfema gramatikore. Vetë tema morfologjike mund të jetë temë e parme, ose përfitim i bashkëveprimit të një teme fjalëformuese me një morfemë fjalëformuese.

tema bazë *hark*, ka një strukturë fonologjike njërrrokëshe të përbërë prej katër fonemash dhe zanoren e theksuar /á/, ndërsa prapashtesa *-tar* ka po ashtu një strukturë njërrrokëshe të përbërë prej tri fonemash (Figura 2):



Figura 2: Struktura fonologjike e njësive morfologjike hyrëse

Në strukturën fonologjike të fjalës komplekse, si njësi dalëse e procesit morfologjik fjalëformues, kemi një rikonfigurim tërësor: metrik dhe prozodik. Për shkak të shfaqjes së fonemës /ë/ në pozicionin midis temës bazë dhe prapashtesës, bashkëtingëllorja /k/ e temës bashkohet në një rrokje me të. Dy rrokjeve (*hark*, *tar*) që u përgjigjen dy njësive hyrëse në proces u përgjigjen tri rrokje (*har*, *kë*, *tar*) të fjalës komplekse. Shtatë fonemave të njësive hyrëse (*hark*, *tar*) u përgjigjen tetë fonema të njësisë dalëse /h/ /a/ /r/ /k/ /ë/ /t/ /a/ /r/. Theksi i fjalës zhvendoset nga /a/ e temës bazë *hark* në /a/ të prapashtesës *-tar*. Lëvizja e theksit, e njohur si “zhvendosje gramatikore” (Memushaj, 2010:154), mendoj se duhet parë në funksion të ligjësisë mbi vendin e theksit në rrokjen fundore të temës së fjalës. Kjo analizë e shkurtër e fjalës *harkëtar* dëshmon se organizimi fonologjik i fjalës komplekse nuk përcaktohet nga njësitë hyrëse të procesit fjalëformues, por lidhet me konstruktin morfologjik sintetik (*harkëtar*) të përfutur nga ky proces. Pra forma përkatëse ka karakter holistik, pasi del si dukuri e përcaktuar nga konstruktin morfologjik dhe jo si shumë e pjesëve përbërëse të tij, temës dhe prapashtesës, dhe as si pasqyrim i ndryshimeve të mundshme që mund të pësojnë ato.

Ndërfutja e kësaj *-ë*-je lidhet me modifikimin fonologjik të temës bazë, përkatësisht me gjatësinë e zanores së theksuar: nga zanore e theksuar e shkurtër [a] në zanore me gjatësi ~ normale. Për këto arsye është më e arsyeshme që *ë*-ja të përkufizohet si një ndërmorfemor që nuk përmbush asnjë funksion morfologjik, por që i përket vetëm strukturës fonologjike të fjalës. Si i tillë ai nuk mund të interpretohet si pjesë e prapashtesës apo temës fjalëformuese, duke mos lënë, në këtë mënyrë, hapësirë për praninë e dy alomorfeve të prapashtesave në fjalë. Prandaj, në vend që të pohojmë praninë e alomorfeve në prapashtesat përkatëse të analizuara këtu, është më e drejtë të

pranojmë ekzistencën e një prapashtese të vetme: *-ko, -lo, -ri, -si, -sirë, -so, -tar, -ti, -to*. Kjo jo vetëm që e thjeshton sistemin e prapashtesave, por i hap udhë edhe shmangies së analizës së fjalëformimit si një proces i thjeshtëzuar i bashkimit të temave me morfemat përkatëse. Fjalëformimi shfaqet si një proces kompleks ngjizës në tri rrafshet: fonologjik, morfologjik dhe semantik.

Rasti i alomorfeve -s/-ës

Siç u vu në dukje në shembujt (2), *nxënës, vjelës, mësues, ndërtues* etj. zazorja mbështetëse /ë/ del para prapashtesës *-s* në rastet kur kjo i bashkohet një teme më bashkëtingëllore. Rregullsia e daljes së /ë/-së në këtë pozicion çon natyrshëm drejt përfundimit se është pikërisht tema bazë më bashkëtingëllore ajo që kërkon një prapashtesë që fillon me zanore. Pikërisht përmbushjen e këtij kushti fonologjik, ligjësi kombinator e fonemave, e plotëson dalja e /ë/-së mbështetëse, e cila, me të drejtë, sipas këtij arsyetimi është për t'u vlerësuar si pjesë e prapashtesës. Por nëse i përqasim me kujdes ligjësitë fonotaktike të kombinimit të fonemave bashkëtingëllore në gjuhën shqipe me rastet e fjalëformimit të njëjive të reja me prapashtesën *-s*, arsyetimi i mësipërm mund të mos duket dhe kaq bindës. Në rastet e formimit të njëjive të reja leksikore nga tema foljore më bashkëtingëllore me anë të prapashtesës *-s*, vërehet se zazorja /ë/ ndërfitet dhe mund të thuhet “shmang” kontaktin midis këtyre bashkëtingëlloreve:

- (4) *hapës ps*
zhytës ts
vrasës ss
prekës ks
njohës hs
shkulës ls
tallës lls
humbës bs
dridhës dhs
shkundës nds
heqës qs
shpifës fs

Nga shqyrtimi i këtyre rasteve, të cilat nuk janë shteruese, por të mjaftueshme për të nxjerrë përfundime të besueshme për analizën e këtushme, dhe përqasja e tyre me tabelën e mundësive kombinuere dhe të përndarjes së grupeve bashkëtingëllore (Memushaj, 2010:221-222), arrihet në përfundimin se jo në të gjitha rastet ndërfitja e /ë/-së diktohet nga kontakti midis dy bashkëtingëlloreve. Sipas këtij autori, kombinimi *ps, ks* ndeshet në fillim: *pse, psikozë, ksilofon, ksenofob*, në mes: *theksoj, theksim*, dhe në fund të fjalës:

haps,-i, theks,-i; ai *fs, ms* ndeshet në mes të fjalës, ndërsa *ls* ndeshet në fund të fjalës: *ëmbëlsoj, vogëlsi* etj. Kjo do të thotë që kur tema bazë mbaron më *-p-*, *-k-*, *-l-*, atëherë midis saj dhe prapashtesës që fillon me *-s-* nuk kërkohet detyrimisht dalja e një elementi epentetik, përkatësisht e zanores mbështetëse /ë/. Krahaso: *haps,-i* ‘burg’, *lyps, lypsem*. Nëse i referohemi edhe shqiptimit të fjalëve *hapëse, kapëse*, do të vërejmë se nuk ndeshen gjurmë të *-ë-së* mbështetëse: [hapse], [kapse]. Këto raste diktojnë që dalja e zanores /ë/ në këtë pozicion duhet motivuar mbi bazën e një ligjësie tjetër.

Temat bazë më bashkëtingëllore që bashkohen me *-s* janë përgjithësisht tema të parme njërrrokëshe. Duke qenë rrokje të mbyllura, prapashtesa *-s*, si element njëfonemor, nuk mund të bëhet pjesë e rrokjes së temës (ose rrokjes fundore të temës, kur nuk kemi tema njërrrokëshe) dhe as mund të krijojë rrokje të mëvetësishme. Për arsye se ajo nuk mund të qëndrojë e mëvetësishme në pozicion fundor, kemi një riorganizim të strukturës metrike të fjalës: futja e /ë/-së mbështetëse bën që të krijohet një strukturë dyrrrokëshe: *hap* ⊕ *s* → *hap-ës*. Në këtë mënyrë kemi një unifikim të modelit fjalëformues, përkatësisht të strukturës fonologjike të fjalës komplekse, si për rastet kur prapashtesa *-s* bashkohet me tema më zanore, ashtu edhe për rastet kur ajo bashkohet me tema më bashkëtingëllore:

- (5) *hap -s* → *hap-ës*
nxënë -s → *nxë-nës*

Edhe analiza e fjalëformimit me anë të prapashtesës *-s* na çon në përfundime të ngjashme me ato për prapashtesat *-tar, -ri, -si* etj. Dalja e elementit /ë/ diktohet nga struktura fonologjike - organizimi metrik i saj - e fjalës së re të përfutur me anë të prapashtesimit dhe jo si një element i nevojshëm për strukturën morfologjike të saj. Në këtë mënyrë ekzistenca e saj brenda strukturës së fjalës komplekse nuk mund të interpretohet si shfaqje e alomorfisë në sistemin e prapashtesave të gjuhës shqipe.

BIBLIOGRAFI

- Agalliu, Fatmir; Angoni, Engjëll; Demiraj, Shaban; Dhrimo, Ali; Hysa, Enver; Lafe, Emil & Likaj, Ethem (1995¹, 2002²). *Gramatika e gjuhës shqipe, vëllimi I, Morfologjia*, Tiranë.
- Booij, Geert (2007² [2005]). *The Grammar of Words. An Introduction to Morphology*, Sec ond Edition, Oxford University Press.
- Booij, Geert (2010). *Construction Morphology*, Oxford, University Press.
- Booij, Geert (2015). “Word-formation in construction grammar”. Në: Peter O. Müller, Inge borg Ohnheiser, Susan Olsen, and Franz Rainer (eds.). *Word Formation. An International Handbook of the Languages of Europe*. Volume 1, Band 40.1: 3124-3137, Berlin/Boston: De Gruyter Mouton.
- Boriçi, Lumnie (1991). “Rreth fonemës ë të shqipes së sotme letrare”. Në: *Studime filologjike*, nr.2, f. 159-174, Tiranë.

- Buxheli, Ludmila (2008). *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.
- Çeliku, Mehmet; Karapinjalli, Mustafa & Stringa, Ruzhdi (1998). *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*. Botimet TOENA, Tiranë.
- DGjSh (1974). *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave të RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- Dhrimo, Ali; Angoni, Engjëll; Hysa, Enver; Lafe, Emil; Likaj, Ethem; Agalliu, Fatmir & Demiraj, Shaban (1976). *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II* (maket), Tiranë
- Genesin, Monica & Matzinger, Joachim (2016). “Albanian”. Në: Peter O. Müller, Ingeborg Ohnheiser, Susan Olsen, and Franz Rainer (eds.). *Word Formation. An International Hand book of the Languages of Europe*, Band 40.5: 3124-3137, Berlin / New York: De Gruyter Mouton.
- Goldberg, Adele E. (1995). *Constructions. A Construction Grammar Approach to Argument Structure*, The University of Chicago Press, Chicago and London.
- Goldberg, Adele E. (2006). *Constructions at Work. The Nature of Generalization in Language*, Oxford University Press.
- Hysa, Enver (2004). *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Tiranë.
- Hysa, Merita (2014). *Struktura e morfemave të shqipes në dritën e fonologjisë leksikore* (Punim doktore), Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë.
- Karagjozi, Mimoza (2009). “Karakteristika të kombinimit të fonemave bashkëtingëllore në kufi të morfemave (temë prapashtesë)”. Në: *Studime filologjike*, nr. 1-2, f. 85-94, Tiranë.
- Memushaj, Rami (2010). *Fonetika e shqipes standarde*, Botim i dytë i përmirësuar, BO TIMET TOENA, Tiranë.
- Xhuvani, Aleksandër & Çabej, Eqrem (1980 [1962]). “Prapashtesat e gjuhës shqipe”, Tiranë. Në: Aleksandër Xhuvani, *Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar, Vëpra 1*, Tiranë, f. 419-581.

SUMMARY

NEW INTERPRETATION OF THE SUFFIX ALLOMORPHY IN THE ALBANIAN LANGUAGE

The objective of this paper has been to analyze the phenomenon of the occurrence of the epenthetic /ë/ in the position between a base stem that ends with a consonant and a suffix that begins with a consonant. The suffixes *-tar*, *-si*, *-ri*, *-shave* been the objects of analysis. In the current studies on word formation in Albanian linguistics, based mainly on the structuralist approach,

this phenomenon, although defined as a phonological one, has led to the acceptance of allomorphy for these respective suffixes. Such a conclusion comes naturally, if we take into account that the morphological structure of the complex word, according to the traditional structuralist approach, is conceptualized as a product of the cooperation between a base stem and the suffix. The consequence of this is that any morphological change that occurs in the structure of the complex word is considered as a reflection of the changes that can undergo in the respective morphological input units.

In this paper another perspective was followed, that of the construction morphology, according to which the structure of the complex word can be represented as a construction in which three structures interact to each other: the phonological structure, the morphological structure, and the semantic one. Any change that happens in the morphological structure, as the basis of a morphological word formation process, is reflected in the changes that occur in the phonological and semantic structure too. But these changes are not a mechanical reflection of the process of merging of two morphological units: the base stem and the suffix. On the contrary, they are motivated and realized according to the rules of organizing of the phonological and respectively semantic structure of the complex word. The participation of such phenomena in the process of word formation leads us to the conceptualization of word formation as a complex process, moving away from its simplified presentation as a concatenation of morphemes, or complex stems with morphemes. The creation of a new lexeme is accomplished through the organization of a new phonological form, which is parallel to the conception of the semantic component. This means that not every change in the phonological structure of the complex word is necessarily a reflection of the changes that undergo the morphological input units of the word formation process.

Following this idea in our analysis we came to the conclusion that the occurrence of the epenthetic *-ë-* is a genuine phonetic phenomenon, determined by the organization of the metric and prosodic structure of the complex word. It has nothing to do with the phonological representation of the morphological units that enter in the word formation process.

Since the phenomenon of epenthetic *-ë-* affects only the phonological structure of the complex word, we consider it inappropriate to accept the allomorphy in the cases when this /ë/ [ə] occurs before the suffix. Therefore, according to the analysis applied here, in the case of the Albanian language, only the presence of the unified suffixes: *-ko*, *-lo*, *-lle*, *-lli*, *-llo*, *-ri*, *-rit*, *-rlo*, *-rmo*, *-ro*, *-rro*, *-s*, *-si*, *-sirë*, *-so*, *-tar*, *-ti*, *-to*, *-zo*, are to be accepted. Such a view should not be interpreted as a denial of allomorphy in the system of suffixes. On the contrary, it is present in other cases, but not in these cases where an *-ë-* appears before the suffix.

